



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Drejtoria e Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural  
Direktoratë e Poljeprerësive i Ruralni Razvoj  
Tarim ve Krsal Kalkinma Mederisiği



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

10-320 Nr. 105691 Dt. 23-07-2019

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Dt. 22.07.2019

## Thirrje për aplikim Për fermerët e Komunës së Prizrenit

"Ngritja e pemishtës me pemë arrore" me participim .

*Të drejtë aplikimi kanë të gjithë fermerët e komunës së Prizrenit të cilët i plotësojnë kriteret e mëposhtëm:*

- Të jetë banor i Komunës së Prizrenit.
- Ngastra të ketë qasje në rrugë gjatë tërë vitit.
- Ngastra të jetë nën sistemin e ujitjes apo në forma tjera të ketë ujë gjatë sezonës kur i nevojitet uji.
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar grande nga i njëjti program vitet paraprake (arra).
- Përparësi kanë fermerët me përvojë në kultivimin e pemëve, të dëshmuar me aplikimin në Programin për Pagesa Direkte.
- Të jetë i gatshëm të marrë pjesë në participim (20%) nga vlera e përgjithshme.
- Sipërfaqja që duhet mbjellur duhet të jetë min, 0.20 ha maksimum 0.30 ha.
- Të jetë i gatshëm ti përmbush të gjitha obligimet nga Marrëveshja e cila nënshkruhet.

### Dokumentacioni i nevojshëm

- Kopja e dokumentit valit të Republikës së Kosovës (letërnjoftim, pasaport, patent shoferi).
- Fleta poseduese dhe kopja e planit të ngastrës ku do të bëhet mbjellja (origjinal), në emër të tij apo të prindërit.
- Dëshmia e aplikimit në programin për pagesa direkte për pemë.
- Dëshmia mbi pagesën e tatimit në pronë.
- Vërtetimi i pagesës së mbeturinave.
- Kopja e çertifikatës së trajnimeve të veçanta ose dëshmi të shkruar që do të marrë pjesë në trajnimin përkatës brenda afatit për kompletimin e projektit.
- **Aplikacioni dorëzohet ne zarfe te mbyllura, në të cilën shënohen:**
- Titulli i Projektit.
- Të dhënat e fermerit (emri e mbiemri, vendbanimi, adresa, nr. i telefonit)

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: **23.07.2019-05.08.2019**  
Dokumentacioni dorëzohet në sportelin nr. 3.

Drejtori,  
  
Egzon Elshani